ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**KEK-23-12442-5-2-1**
Nr i brendshëm	**KEK-23-381-521**

Sa i përket tenderit për: "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest-faza e parë".

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

ASSET ING SH.P.K. &EKO-TEAM

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Gazmend Zajmi, Kompleksi Puhiza, Hy. 4, Nr. 12

(Adresa)

Prishtinë *10000*

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38349600419 *N/A*

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Mimoza Hasani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

asseting.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

26.04.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ASSET ING SH.P.K. PRISHTINË

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 14.11.2023 Hapja e ofertave: 07.12.2023 Njoftimi mbi vendimin e AK-së:08.04.2024 Kërkesa për rishqyrtim: 13.04.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 18.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë ka qenë 14.11.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 07.12.2023, ku kanë marr pjesë gjithsejtë katër ofertues.
Njoftimi mbi vendimin e AK-së është bërë me dt.08.04.2024, ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

- Ju nuk keni ofruar nje (1) ekspertë i lincencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje të asbestit-projektmenaxher
- Ju nuk keni ofruar pecialistin/Expertin për udhëheqje te punëve per heqje(sanimin) e azbestit , OE duhet te dorëzoj çertifikata apo licenca për azbest te lëshuara nga Instituti qe eshte i çertifikuar per Trajnimin e Eksperteve .
- Ju nuk keni dorezuar te dhenat per çertifikim te Institutit te akredituar per trajnim te eksperteve, prandaj konkludojme se ne kete pike OE nuk i permbush kriteret sipas DT
- Prandaj konkludojme se ne kete pike OE nuk i permbush kriteret sipas DT.
- Çertifikata nuk ka validitet pasi eshte leshuar ne vitin 19.05.2017 dhe sipas normave te EU te cilave ju eshte referuar DT- Rezoluta e Parlamentit Evropian e 20 tetorit 2021 me rekomandime për Komisionin për mbrojtjen e punëtorëve nga azbesti (2019/2182(INL)) bazuar ne Direktivën 2009/148/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 30 nëntorit 2009 për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë ,citat:

- Ju nuk keni deshmue me çertifikata per secilen pjese qe ka perfunduar trajnimin.
- Ju nuk keni deshmi mbi eksperiencen te deshmohet me CV mbi projektet e realizuara ne 5 vitet e fundit.
- Eksperti i licencuar duhet të jetë ekspert i fushës me konfirmim te provimit –specialist per heqjen e azbesit sipas normave të EU me referenca në azbest,me te pakten 5 vite pervoje pune.
- Ju me çertifikate valide duhet te deshmohet qe eksperti/Specialisti eshte trajnuar per heqjen, sanimin e se paku dy llojeve te azbestit dhe te jete i çertifikuar per keto fusha:
- Ju nuk keni personit te prezentuar me titullin Ekspert/Specialist konkludojme se i njejti nuk i permbush kriteret sipas DT,pasi qe nuk ka paraqitur deshmi qe ka se paku 5 vjet pervoje ne pune me reference ne azbest,sipas normave te EU.Te vetmen deshmi e ka ate te vitit 2017 kur ka qene i angazhuar ne Eko Team, Shkup, Maqedoni si konsulent i jashtëm dhe jo si

Fillimisht ju sqarojmë se të gjitha arsyet e autoritetit kontraktues për eliminimin tonë janë të paqëndrueshme dhe të njëjtat do ti sqarojmë si në vijim:

Në lidhje me arsyen e parë të eliminimit tonë ku AK-ja e ka cekur se ne nuk e kemi ofruar 1 ekspert të licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje të asbestit-projekt menaxher, ju sqarojmë se ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm. Ne në ofertë për inxhinierin e lartcekur e kemi prezantuar z.Shaban Hereqin i cili është edhe projekt menaxher për këtë aktivitet të prokurimit dhe i njëjti e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Më poshtë po e bashkangjesim edhe një herë dëshminë që i njëjti ka përfunduar provimin sipas rregullativës ndërkombëtare.

INTERCERT®
CERTIFICATION

This is to certify that:

Shaban Hereqi

born 25.09.1981
has successfully achieved the:

"Process license for Asbestos Removal"

This process certificate has been issued by Intercert Certification on the basis of the area-specific certification standard 'Process Certificates for Asbestos Inventory and Asbestos Removal' referred to in articles 4.27 and 4.28 of the Working Conditions Regulation, in accordance with the current certification regulations.

Autoriteti kontraktues e ka cekur se nuk e kemi ofruar specialistin/Ekspertin për udhëheqje te punëve për heqje(sanimin) e azbestit , OE duhet te dorëzoj çertifikata apo licenca për azbest te lëshuara nga Instituti qe është i certifikuar për Trajnimin e Eksperteve.
Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se nëse analizohen dokumentet tonë me të cilat kemi ofertuar shihet qartë se ne i kemi prezantuar jo vetëm një apo dy certifikata, mirëpo edhe ë shumë. Andaj kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktues që ti analizoj edhe një herë në tërësi dokumentet tona dhe të nxjerr një vendim meritor në lidhje me ofertën tonë, pasi që ne jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Si arsye tjetër për eliminimin tonë AK-ja e ka cekur se *"Ju nuk keni dorëzuar te dhëna për certifikim te institutit te akredituar për certifikim te eksperteve, prandaj konkludojme se ne kete pike nuk e përmbushë OE"*. Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se në dosje të tenderit nuk ka qenë kërkesë që OE të prezantojnë edhe certifikatat e institutit të akredituar. Arsyeja e lartcekur është në kundërshtim të plotë me nenin 56.3 të LPP-së, ku specifikohet qartë *"3.Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*.
Edhe përkundër faktit të lartcekur autoriteti kontraktues edhe pse nuk ka qenë një kërkesë e tillë në dosje të tenderit, atëherë e njëjta ka mundur të kërkoj sqarime direkt nga laboratori, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.
Këtë veprim të autoritetit kontraktues ne nuk mund ta konsiderojmë ndryshe përveç se diskriminim i hapur ndaj kompanisë tonë, ku edhe pse jemi OE i përgjegjshëm me çmim më

të lirë po diskriminohemi duke u eliminuar me arsyetime krejtësisht të pa bazuara dhe për kërkesa të cilat nuk kanë qenë të specifikuara në dosje të tenderit.

Autoriteti kontraktues si arsye tjetër për eliminimin tonë tek njoftimi mbi vendimin e saj e ka cekur si në vijim:

- Çertifikata nuk ka validitet pasi eshte leshuar ne vitin 19.05.2017 dhe sipas normave te EU te cilave ju eshte referuar DT- Rezoluta e Parlamentit Evropian e 20 tetorit 2021 me rekomandime për Komisionin për mbrojtjen e punëtorëve nga azbesti (2019/2182(INL)) bazuar ne Direktivën 2009/148/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 30 nëntorit 2009 për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë ,citat:

Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është absurd për faktin se e njëjta me çdo kusht po mundohet të na eliminoj nga ky aktivitet të prokurimit, e tani duke u thirr edhe në disa norma të EU. Ne edhe një herë po e sqarojmë se arsyeja e AK-së është e paqëndrueshme për faktin se certifikata të cilën ne e kemi prezantuar është valide pasi të njëjtës i figuron data e lëshimit të saj dhe e njëjta nuk posedon datë skadence. Në momentin që një dokumenti nuk i figuron data e skadencës kuptohet qartë se dokumenti i tillë është valid nga momentin i lëshimit të atij dokumenti.
Po ashtu ju sqarojmë se trupa certifikuese punon e cila ka lëshuar certifikatën e tillë vepron sipas rregullativave ndërkombëtare për certifikim të eksperteve, dhe validitetin e certifikimit e përcakton programi kurrikular i akredituar. Andaj ne edhe një herë po e sqarojmë se konstatimi i autoritetit kontraktues është tejet tendencioz dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së.

Si arsye tjera për eliminimin tonë AK-ja ka dhënë arsyet si në vijim:
-Ju nuk keni dëshmuar me certifikata për secilën pjesë të përfunduar te trajnimit.
-Ju nuk keni dëshmi mbi eksperiencën, te dëshmohet me CV mbi projektet e realizuara ne 5 vitet e fundit.
Fillimisht po e sqarojmë se autoriteti kontraktues me qëllim që të shtoj sa më shumë arsye të eliminimit, i ka përsëritur pothuajse disa herë për të njëjtin inxhinier arsyet e njëjta. Në lidhje me arsyet e lartcekura ne edhe një herë po e sqarojmë se të njëjtat nuk qëndrojnë për faktin se ne i kemi prezantuar të gjitha certifikatat e kërkuara tek kërkesa e dosjes së tenderit dhe të njëjtat duhet të merren parasysh. Gjithashtu ne e kemi prezantuar edhe CV mbi eksperiencën, ku është specifikuar saktë përvoja e punës në institucionet ku ka punuar inxhinieri i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues.

Kërkojmë nga ana e AK-së ti analizoj edhe një herë në detaje të gjitha dëshmitë e prezantuara nga ana jonë me rastin e ofertimit, pasi që në momentin që analizohen në tërësi këto dokumente, atëherë kuptohet qartë se ne i përmbushim në tërësi të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Autoriteti kontraktues në njoftimin mbi vendimin e saj na ka eliminuar edhe me një arsye tjetër si në vijim:

- Eksperti i licencuar duhet të jetë ekspert i fushës me konfirmim te provimit –specialist per heqjen e azbesit sipas normave të EU me referenca në azbest,me te pakten 5 vite pervoje pune.

Sikurse arsyet tjera edhe kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme për faktin se eksperti i licencuar ka dëshmuar përmes dokumentacionit të cilin ne e kemi prezantuar se ka përfunduar provimin përfundimtar për licencim me datën 19.05.2017, dhe posedon përvojën e kërkuar te punës. Mirëpo se si AK-ja ka ardh në një përfundim të tillë ne nuk e dijmë,

mirëpo këtë veprim ne e shohim si tendencioz kundrejt kompanisë tonë, pasi që po eliminohemi me arsyetime të cilat janë krejtësisht të pa bazuara.

Në vijim të njoftimit mbi vendimit të AK-së është cekur po ashtu si më poshtë:
Ju me certifikate valide duhet te dëshmoni se eksperti eshte i certifikuar per hjeqjen e se paku dy llojeve te azbestit dhe te jete i certifikuar per këto dy fusha.

Sa për sqarim të AK-së ne në ofertë kemi ofruar dëshmi se eksperti i prezantuar nga ana jonë është i certifikuar për largimin e azbestit për të gjitha llojet e azbestit që hyjnë në kategorinë 2 dhe 2A të rrezikshmërisë. Pra eksperti të cilin ne e kemi angazhuar jo vetëm që e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, mirëpo i njëjti edhe e tejkalon atë pasi që është i certifikuar jo vetëm për dy fushat të cilat i ka cekur AK-ja mirëpo është i certifikuar edhe për shumë fusha tjera. Si dëshmi më poshtë po e bashkangjesim si foto edhe përshkrimin nga certifikata e inxhinierit tonë:

Intercert Certification declares that there is justified confidence that the process of:
1) removing asbestos or asbestos-containing products, classified as risk class 2 or 2A;
2) clean-up of asbestos or asbestos-containing products, classified as risk class 2 or 2A, which were released in consequence of an incident,

Andaj edhe arsyetimi i lartcekur i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, pra kërkojmë që të analizohen edhe një herë në tërësi të gjitha dokumentet e prezantuara nga ana jonë me rastin e ofertimit.

Autoriteti kontraktues e ka cekur se:

Operatori Ekonomik, në CV-në e personit të prezentuar me titullin Ekspert/Specialist konstatojmë se i njëjti nuk i përmbush kriteret sipas DT, pasi që nuk ka paraqitur dëshmi që ka se paku 5 vjet pervojë në punë me referencë në azbest, sipas normave te EU.Të vetmen dëshmi e ka atë të vitit 2017 kur ka qenë i angazhuar në Eko Team, Shkup, Maqedoni si konsulent i jashtëm **dhe jo si ekspert** për Mbeturina dhe Mbetje të Rrezikshme dhe Transport, në periudhë të paspecifikuar.
Çertifikatat e prezentuara për "Materialet që permbajne azbest, lesh mineral dhe transportimi","Pajisjet për monitorim të ajrit dhe rrjedhes së larë të ajrit", lëshuar nga Institut Mol, Stara Pazove (Serbi), sipas standardit serb SRPS ISO 29993 i cili nuk pranohet si standard në Republikën e Kosovës dhe çertifikatat nuk janë nostifikuar nga organet pergjegjëse të Republikës së Kosovës, siq parashihet me marrevëshjen për njohjen e diplomave/çertifikatave te vitit 2015 në mes RKS dhe RS.

Sa i përket arsyes së lartcekur ju sqarojmë se autoriteti kontraktues na ka diskriminuar në këtë rast, pasi që i njëjti në lidhje me kërkesën e lartcekur është dashur të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe ne do të e kishim prezantuar edhe referencën e kërkuar. Sa për sqarim ne i posedojmë referencat e lëshuara për inxhinierin, mirëpo që gjatë dorëzimit të ofertës ka ndodhur një lëshim teknik ku nuk janë bashkangjitur edhe referencat e të njëjtit.

Ndërsa sa i përket arsyetimit të AK-së se kinse i njëjti inxhinier është angazhuar si konsulent dhe ekspert, ju sqarojmë se ky arsyetim është i pa bazuar, pasi që i njëjti ka qenë i angazhuar dhe e posedon përvojën e kërkuar si ekspert, konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Gjithashtu në lidhje me arsyen tjetër ku është cekur se nuk janë nostrifikuar certifikatat e prezantuara, ju sqarojmë se një kërkesë e tillë nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit, andaj edhe në këtë rast ky konstatim është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.
Mirëpo pa marr parasysh këtë fakt, kur dihet se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë, atëherë autoriteti kontraktues me qëllim të trajtimit të barabartë dhe trajtim të drejtë është dashur të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me referencat, ashtu siç parashihet në dispozitat e nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Arsyet e eliminimit tonë të cilat po i kontestojmë më poshtë i kemi hasur tek raporti i vlerësimit, pasi që letra standarde e cila na është dërguar është jo e plotë, pra edhe në këtë

rast jemi diskriminuar pasi që nëse nuk do ta kishim kërkuar raportin e vlerësimit, arsyet e tilla nuk do të kishim mundësi ti shohim.

Konstatojmë se OE nuk i përmbush kriteret e kërkuar sipas DT. I njëjti konstatim vlenë edhe për të gjitha çertifikatat tjera në dosjen e OE të lëshuara nga Instituti Mol për inxhinierët dhe së paku 5 punëtor të çertifikuar për punë me asbest sipas standarteve ISO 29993 ose TRGS 519 per azbest.

Sa i përket arsyes së lartcekur, ashtu siç edhe e cekëm më lartë ne i kemi prezantuar të gjitha certifikatat e kërkuara dhe të njëjtat janë konform kërkesave të dosjes së tenderit, ndërsa në lidhje me nostrifikimin, ashtu siç edhe e cekëm më lartë një kërkesë e tillë nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit dhe ne nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi për kërkesa të cilat nuk janë specifikuar në dosje të tenderit.

Arsyeja tjetër tek raporti i vlerësimit ka qenë si në vijim:

Në DT është kërkuar: **8. Dy (2) punetor te trajnuar per paketimin dhe transportin e mbetjeve te rrezikshme me ADR.**
Te deshmohet me certifikate te perfundimit me sukses te trajnimit me ADR te leshuar nga nje institute i licencuar qe nenkupton se punetoret jan te trajnuar ne paketimin dhe transport te mbetjeve te rrezishme.

OE ne dosjen e tij ka dorezuar çertifikatat për afësim profesional të vozitësve për transport të materieve të rrezikshme për dy punëtorë, por të njejtit nuk është dëshmuar se janë të aftësuar për paketim të mbetjeve të rrezikshme sipas kerkeses në DT.

Ky arsyetim i komisionit vlerësues është tendencioz dhe diskriminues për kompaninë tonë, pasi që kur analizohet dokumentet e prezantuara nga ana jonë shihen qartë certifikatat për të dy punëtorët e kërkuara. Të njëjtit janë të aftësuar për paketim të mbetjeve të rrezikshme, ashtu siç është specifikuar në dosje të tenderit. Ju lutem analizojeni në tërësi dokumentin me titull "Certifikatat ADR", ndërsa pasi të analizoni në tërësi atëherë do të kuptohet shumë lehtë dhe qartë se ne i kemi prezantuar punëtorët sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Tek raporti i vlerësimit si arsye për eliminimin tonë është vendosur si në vijim:

Në DT është kërkuar: **9. Laborator i akredituar sipas standardeve ISO 17025, dhe metodes SEM/EDX/(Scanning Electron Microscopy-VED 3492, VDI3866, BIA7478).**
Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi laborator ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi me laborator të akredituar sipas standardeve ISO 17025, dhe metodes SEM/EDX/(Scanning Electron Microscopy-VED 3492, VDI3866, BIA7478 të dëshmohet posedimi ose të deshmohet me marrëveshje bashkëpunimi me laborator të akredituar, origjinale ose te noterizuar.
OE ka dorëzuar një marrëveshje të noterizuar me SGS Albania, por laboratori i akredituar në Shqipëri sipas standardeve ISO 17025, nuk përmban metodën SEM/EDX/(Scanning Electron Microscopy-VED 3492, VDI3866, BIA7478).
OE ka bashkangjitur edhe akreditimin dhe një aneks të deklarimit të akreditimit të SGS Search Laboratorium B.V Hesswijk Dinther Holande por nuk ka bashkangjitur marreveshje me këtë laborator.

Edhe arsyeja e lartcekur është e paqëndrueshme për faktin se ne me rastin e dorëzimit të ofertës i kemi bashkangjitur edhe dokumentet të cilat e tregojnë qartë se laboratori me të cilin ne kemi bashkëpunuar është i akredituar sipas kërkesës së dosjes së tenderit.
Tek dokumenti "Marrëveshja me laborator" është bërë me ngjyrë të gjelbërt pjesa ku vërtetohet qartë se laboratori me të cilin kemi lidhur marrëveshje është i akredituar sipas kërkesës së dosjes së tenderit. **Shih më poshtë:**

7.		Identification and (semi) quantitative determination of asbestos; scanning electron microscopy and X-ray micro analysis	L12, L13 en L15 VDI3866 Blatt 5	Hee Ams

Duhet cekur fakti se kur analizohet raporti i ri vlerësimit të tenderëve shihet qartë se njëri nga anëtarët e komisionit vlerësues nuk është pajtuar të mendimin e dy anëtarëve tjerë dhe kjo tregon qartë diskriminimin që po na bëhet neve si kompani në këtë aktivitet të prokurimit.
Anëtari i komisionit vlerësues e ka cekur si në vijim:

Anetari I komisionit nga ZEP ndan mendimin pasi qe mendon se per pikat e eleminimit te OE me cmim me te lire Asset dhe per grupin e OE Interlab ka hapsir per sqarime konfrom nenit 72.
Per OE ASSET mendimi ime eshte I ndare per arsyjet si vijon:
Ne lidhje me te dhenat e insituit mendoj se ka hapsir per sqarime konfrom nenit 72
Ne lidhje me piken e deshmimit per aftesimit proferional per paketim per OE Asset mendoj se ka hapsir per sqarime konfrom neni 72
Sa I perket pikes eleminuese se OE ka prezantur marrveshje te **noterizuar** me SGS Albanian mirpo ky laborator nuk permban metoden SEM/EDX nuk pajtohem pasi qe SGS Albanian sipas asaj qe shihet qenka pike e laboratorit B.V Hesswijk dhe me kete rast deklarata qe e ka prezantuar OE sipas mendimit tim mjafton.

Pra asnjëri nga mendimet e anëtarit të komisionit nuk janë marr parasysh edhe pse është dashur të kërkohen sqarime shtesë për pikat të cilat AK-ja e ka parë të nevojshme, mirëpo që e njëjta nuk ka kërkuar asnjë sqarim shtesë dhe ky fakt tregon qartë diskriminimin që po na bëhet neve si OE i përgjegjshëm me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ku na ka eliminuar neve edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht kemi ofertuar me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne me dt.18.04.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues ka konstatuar se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që një vendim i tillë nuk është arsyetuar duke u bazuar në dispozita ligjore dhe nuk është dhënë asnjë dëshmi konkrete për një refuzim të tillë.

Kur analizohet vendimi i autoritetit kontraktues shihet qartë se të gjitha arsyetimet e saj janë përsëritur dhe janë të njëjtat me arsyet e eliminimit të kompanisë tonë tek njoftimi mbi vendimin e AK-së.
Autoriteti kontraktues me një veprim të tillë e ka vërtetuar se pretendimet tona janë të qëndrueshme pasi që nëse pretendimet tona do të ishin të paqëndrueshme, atëherë autoriteti kontraktues do ti kishte kundërshtuar të njëjtat me fakte konkrete, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë.

Andaj ne edhe një herë po e sqarojmë se vendimi i AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit dhe vendimi i saj për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, janë vendime të cilat janë nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, pasi që jemi diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Kërkojmë nga ana e ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues të OSHP-së ti analizoj në detaje pretendimet tona ankimore dhe njëkohësisht të nxjerrët një vendim meriton sa i përket ankesës tonë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë edhe në kundërshtim me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga

kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu ju nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.*

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, e bazuar ankesa e OE **ASSET ING SH.P.K. &EKO-TEAM**

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 7,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*